

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Alb.M Construction”

Bazuar në nenin 230 e vijues të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 ”Për Regjistrimin e Biznesit” me vullnetin tim të lirë dhe të shprehur me nënshkrimin e këtij Akti, sot ditën e hënë 5 gusht 2024, unë themeluesi:

-Z/Oltjon Muçogllava, i datëlindjes 22/03/1989, lindur në Berat, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I90322077L, letër njoftim nr. 036379386, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Deklaroj se:

Kam vendosur të nënshkruaj këtë Akt Themeli për krijimin e shoqërisë tregtare private **“Alb.M Construction”**, me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), më poshtë referuar” shoqëria” aktiviteti i të cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë, duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar në per gjithësi dhe të ligjit ”Për tregtarët dhe shoqërite tregtare” në vecanti.

Akti i themelimit të shoqërisë **“Alb.M Construction”** Sh.p.k është hartuar mbi bazën e këtyre principeve:

NENI 1 Forma dhe Emri

Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë është **“Alb.M Construction”** Sh.p.k.

NENI 2 Baza Ligjore

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 ”Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.



NENI 3
Selia Ligjore

Selia dhe qendra e kësaj shoqërie është në adresën: **Pasuria me Nr.11/85+4-5,Zona Kadastrale Nr.8501,Lagjja “Clirim”,P 23,SH 4,Kati i tretë,Ap.5 Berat.**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimitarinë shoqëria.

NENI 4
Kohëzgjatja dhe prishja e shoqërisë

Shoqëria tregtare krijohet për të zhvilluar aktivitetin e saj për një afat të kohor të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent Qendra Kombëtare e Biznesit. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likujdimi me vendim të Asamblese së Ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

NENI 5
Objekti i veprimitarisë

Shoqëria “Alb.M Construction” Sh.p.k. ka si objekt të veprimitarisë së saj:

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimitarive në fushen e energjisë. Konkretisht: Themelimi, ndërtimi dhe menaxhimi i shkollave jo publike fillore, të mesme, fakulteteve dhe instituteve arsimore. Shoqëria do të organizoj konferanca dhe panaire tregtare kombëtare.Eskport, import dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjithe llojeve të materialeve dhe pajisjeve të ndërtimit, të mallrave të ndryshme industriale dhe ushqimore dhe mallrave të të gjitha llojeve.Administrimi, blerja, shitja, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme dhe aseteve të tjera të ngjashme, vepra civile, tregtare, industriale, private ose publike. Studimi, projektimi, konsulenca, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit për realizimin me fonde publike dhe/ose jo publike të veprave me karakter shfrytëzimi/administrimi publik ose privat.Studimi, projektimi, konsulenca, sipërmarrjen dhe krijimin e agjensive turistike.Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë, importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve të teknologjise në fushën energjitikes.Shoqëria mund të ushtojet veprimitari të ndërmjetësimit apo lidhjes së kontratave ndërmjet personave fizikë apo juridikë publikë, shtetëror dhe privat, vendas dhe të huaj.



AKT THEMELIMI “Alb.M Construction” SHPK

NENI 6 *Kapitali Themeltar*

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Alb.M Construction” është në masën 100.000 Lek (njëqind mijë), i ndarë në 1(një)kuotë që zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë:

1- Oltjon Muçogllava 100.000 Lekë (njëqind mijë) 100 %

Kapitali themeltar i shoqërisë do te shlyhet tërësisht dhe depozohet në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë pasi shoqëria të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 7 *Aktet e Shoqërisë*

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të percaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8 *Organet Drejtuese*

Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “Alb.M Construction” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta, në numër. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijuar të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje është emëruar **Z/Oltjon Muçogllava**, i datëlindjes 22/03/1989, lindur në Berat, i identifikuar me kartën e identitetit me numër personal I90322077L, letër njoftim nr.036379386, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar..

NENI 9 *Dispozitat e fundit*

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Statutin dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptar në përgjithësi.

Shoqëria do të ketë vulën, stemën, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësitë do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve në veçanti dhe me propozim të Administratorit.

Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarre -veshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.



AKT THEMELIMI “Alb.M Construction” SHPK

Ky Akt Themelimit është hartuar në 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi të njëjtë ligjore.
Akt Themelimi u redaktua në gjuhën shqipe.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“Alb.M Construction” Sh.p.k

OLTJON MUÇOGLLAVA

Oltjon Muçogllava

Berat, më 05.08.2024